



Bazuar në nenin 35, paragrafi 1.1, të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 77 / 16 gusht 2010) dhe nenin 13 të Ligjit Nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 10 / 8 maj 2012), Bordi i Bankës Qendrore, në mbledhjen e mbajtur më datë 29 nëntor 2018, miratoi këtë:

## **Rregullore për themelimin e fondit plotësues pensional të punëdhënësit**

### **Neni 1**

#### **Qëllimi dhe fushëveprimi**

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta, si dhe parimet dhe udhëzimet për themelimin e Fondeve Plotësuese Pensionale të Punëdhënësit.
2. Kjo rregullore aplikohet për Punëdhënësit që themelojnë Fonde Plotësuese Pensionale të Punëdhënësit (Fondi Pensional).

### **Neni 2**

#### **Përkufizimet**

1. Të gjitha termat e përmendura në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përcaktuara në nenin 1 të Ligjit nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës dhe nenin 1 të Ligjit nr. 04/L-168 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës (në vijim: Ligji për Fondet Pensionale) dhe/ose me përkufizimet e përcaktuara si më poshtë për qëllimin e kësaj rregulloreje:
  - 1.1 *Akt Themelues* - nënkupton dokumentin e shkruar juridik, i nënshkruar nga organi më i lartë qeverisës i punëdhënësit, me të cilin themelohet Fondi Pensional si person juridik jofitimprurës.
  - 1.2 *Pensioni Invalidor* - nënkupton pensionin i cili përfitohet para arritjes së moshës 65 vjeçare nga personi i cili vuan nga paaftësi e kualifikuar dhe që legjislacioni në fuqi i jep atij të drejtën e shfrytëzimit të pensionit.
  - 1.3 *Mosha e pensionimit* - nënkupton moshën 65 vjeçare;
  - 1.4 *Sponsor* - nënkupton Punëdhënësin që themelon Fondin Pensional.

### **Neni 3**

### **Kërkesat e përgjithshme për themelimin e Fondit Plotësues Pensional të Punëdhënësit**

1. Fondi Pensional themelohet me Aktin e Themelimit të miratuar nga Punëdhënësi që sponsorizon Fondin Pensional.
2. Fondi Pensional themelohet si person juridik jofitimprurës.
3. Bordi i Drejtorëve të Fondit Pensional, duhet të përbëhet nga jo më pak se 3 (tre) dhe jo më shumë se 15 (pesëmbëdhjetë) anëtarë.
4. Bordi i Drejtorëve duhet të veprojë si fiduciar i mjeteve të pensionit dhe është përgjegjës për menaxhimin e Fondit Pensional.
5. Bordi i Drejtorëve përbëhet prej anëtarëve të emëruar nga sponsori dhe anëtarëve që përfaqësojnë pjesëmarrësit. Statuti do t'i specifikojë kriteret dhe procedurën e zgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Drejtorëve. Anëtarët që përfaqësojnë pjesëmarrësit duhet të përbëjnë shumicën. Nëse ekziston Sindikata e Punëtorëve që përfaqëson punonjësit, përfaqësuesit e pjesëmarrësve mund të emërohen nga Sindikata e Punëtorëve. Nëse nuk ka Sindikatë të Punëtorëve, mekanizmat tjerë për zgjedhjen ose emërimin e përfaqësuesve të pjesëmarrësve duhet të specifikohen në Statut. Në rastet kur anëtarët duhet të zgjedhën, duhet të shfrytëzohet procedurë e thjeshtë e zgjedhjes.
6. Dokumenti i emërimit të anëtarëve të Bordit të Drejtorëve duhet të dorëzohet në BQK, i vërtetuar nga Sponsorin e Fondit Pensional dhe Sindikata e Punëtorëve, nëse aplikohet. Anëtarët e Bordit të Drejtorëve të Fondit Pensional duhet të miratohen paraprakisht nga BQK-ja.
7. Bordi i Drejtorëve emëron Mbajtësin dhe Menaxhuesin e Mjeteve, nëse aplikohet në pajtim me kërkesat e rregullativës në fuqi për Mbajtësin e mjeteve të pensioneve dhe Menaxhuesin e Mjeteve të pensionit.
8. Sponsorin zotohet për të bërë kontribute të pensionit sipas marrëveshjeve përkatëse. Në lidhje me Pensionet me Shuma të Caktuara, Sponsorin duhet të pajtohet që të japë kontribute të mjaftueshme, që të mbajë planin e financimit të pensionit në pajtim me nenin 14.11 të Ligjit për Fondet Pensionale.
9. Bordi i Drejtorëve të Fondit Pensional dhe Sponsorin duhet të miratojnë aktet normative të Fondit Pensional dhe të ndërmarrin një fushatë informative në lidhje me aktet normative të Fondit Pensional dhe marrëveshjet pensionale për të gjithë punonjësit që janë të pranueshëm për pjesëmarrje në skemën e pensionit.
10. Aplikimi për licencimin e Fondit Pensional në BQK duhet të bëhet në pajtim me kërkesat e Rregullores për Licencimin e Fondeve Plotësuese Pensionale të Punëdhënësit.

### **Neni 4**

#### **Kërkesat e veçanta për themelimin e Fondit Plotësues Pensional të Punëdhënësit**

1. Aktet normative të Fondit Pensional përmbajnë elementet si në vijim:
  - 1.1 Forma e Fondit Pensional (Shumave të caktuara ose Kontributeve të caktuara);
  - 1.2 Emri, lokacioni, dhe të dhënat bankare të Fondit Pensional dhe të Sponsorit;

- 1.3 Specifikimi për mbajtjen e mbledhjeve të Bordit të Drejtorëve, e cila mbledhje duhet të mbahet se paku një herë në 6 muaj;
- 1.4 Kushtet për anëtarësimin e nëpunësve individualë si pjesëmarrës të Fondit Pensional;
- 1.5 Kategoritë profesionale të nëpunësve që marrin pjesë në Fondin Pensional, nëse nuk marrin pjesë të gjithë nëpunësit;
- 1.6 Procedura për dhënien e kontributeve dhe obligimet e punëdhënësit dhe punonjësve (nëse aplikohet) që të kontribuojnë;
- 1.7 Procedura për përcaktimit e metodologjisë aktuaristike që do të shfrytëzohet në bërjen e pagesave të Pensioneve me Shuma të Caktuara.
- 1.8 Për Fondin Pensional me Shuma të Caktuara, plani për përcaktimin e të drejtave të fituara të pjesëmarrësve, duke treguar vitet e shërbimit të kërkuara për një të drejtë të akumuluar që nuk tejkalon 5 vite; metodologjia e shfrytëzuar për llogaritjet aktuaristike që përcaktojnë shumën e kërkuar të kontributit të punëdhënësit për të plotësuar kërkesat e financimit të plotë në pajtim me nenin 14.11 të Ligjit për Fondet Pensionale; procedura, koha dhe mënyra për pjesëmarrësit që të pranojnë pasqyrat e raportuara mbi zhvillimin e menaxhimit të mjeteve të Fondit Pensional.
- 1.9 Për Fondin Pensional me Kontribut të Caktuar, një pasqyrë (deklaratë) për të drejtat e fituara plotësisht të pjesëmarrësve në të gjitha mjetet e pensionit të shpërndara në llogaritë individuale; procedurat për mbajtjen e shënimeve në lidhje me kontributet dhe zhvillimin e investimeve (fitimi ose humbja) në llogaritë individuale; Fondi Pensional në intervale të rregullta dhe së paku një herë në çdo dymbëdhjetë (12) muaj e informon çdo pjesëmarrës me shkrim për mjetet në llogarinë individuale të pjesëmarrësit, me datat e kontributeve dhe shumat e fitimit nga investimi;
- 1.10 Obligimet e Fondit Pensional;
- 1.11 Deklarata e parimeve të investimit për mjetet e pensioneve, duke përfshirë shpërndarjen (alokimin) e mjeteve, përzierjen, shpërndarjen e rrezikut (diversifikimin) dhe çështje tjera si dhe procedura për zgjedhjen e Menaxhuesit të Mjeteve;
- 1.12 Procedura për zgjedhjen e Mbajtësit dhe ruajtjen e mjeteve të pensionit;
- 1.13 Kushtet, procedurat dhe format e pagesës së pensionit për pjesëmarrësit, duke përfshirë nëse aplikohen benefitet e pensionit invalidor si dhe benefitet dhe të drejtat e përfituesve;
- 1.14 Kushtet dhe procedurat për transferimin e pjesëmarrësit ose të drejtës së asaj/atij për benefitet e shtyra të pensionit në rast të përfundimit të punësimit, të drejtat e pjesëmarrësit për t'u transferuar në rast të likudimit ose bankrotimit të Sponsorit;
- 1.15 Procedurat dhe formalitetet e kërkuara për ndryshimin dhe plotësimin e akteve normative të Fondit Pensional;
- 1.16 Procedurat e kërkuara në shuarjen e Fondit Pensional;
- 1.17 Elemente tjera që BQK-ja mund t'i kërkojë.

2. Aktet normative duhet të përmbajnë edhe deklaratën e parimeve të investimit, e cila duhet të përmbajë së paku elementet si në vijim:
  - 2.1 Karakteristikat kualitative të investimeve që ofrojnë siguri dhe profitabilitet në investime;
  - 2.2 Objektivat kuantitative të kthimit nga investimet dhe mënyrën e arritjes së këtyre objektivave vit pas viti;
  - 2.3 Limiti maksimal proporcional që mund të vendoset në një lloj të investimit, në pajtim me kërkesat e Ligjit për Fondet Pensionale;
  - 2.4 Limiti maksimal proporcional që mund të investohet në një emetues ose në një entitet (subjekt);
  - 2.5 Format, llojet dhe klasat e investimeve ku mjetet nuk mund të investohen;
  - 2.6 Kërkesat minimale të likuiditetit ose kërkesat e nevojshme të investimeve totale.
  - 2.7 Mënyra me të cilën performanca e investimeve është raportuar nga Bordi i Drejtorëve për pjesëmarrësit dhe për BQK-në;
  - 2.8 Shfrytëzimi i këshillave të ekspertit nga Menaxhuesit e Mjeteve, këshilltarët profesional të investimeve, këshilltarët financiarë dhe profesionistët tjerë në investimet e mjeteve të pensioneve;
  - 2.9 Një sistem të brendshëm ose mekanizëm ku pjesëmarrësit mund t'i parashtrojnë propozimet dhe komentet në lidhje me investimet dhe mënyrën me të cilën Bordi i Drejtorëve i adreson ato;
  - 2.10 Koha, frekuenca dhe mënyra në të cilën Bordi i Drejtorëve shqyrton deklaratën e parimeve të investimeve, procedura nëpërmes të cilës duhet të bëhen ndryshimet e kësaj deklarate edhe procedurat me të cilat pjesëmarrësi dhe BQK-ja do të njoftohen për këto ndryshime.

## **Neni 5**

### **Parimet dhe udhëzimet për themelimin e Fondit Pensional të Punëdhënësit**

1. Për themelimin e Fondit Pensional dhe formulimin e akteve normative të Fondit Pensional dhe në zbatimin e programit të pensionit, duhet të respektohen, parimet dhe udhëzimet si në vijim:
  - 1.1 Ndarja e mjeteve të pensionit. Fondi Pensional është person juridik i veçantë nga Sponsorit. Mjetet e pensioneve duhet vazhdimisht të jenë të ndara nga mjetet e Sponsorit në të gjitha çështjet në lidhje me kontrollin, Mbajtësin, investimet dhe Menaxhuesin e Mjeteve.
  - 1.2 Zbatimi i sistemit të financimit. Mjetet e Pensioneve duhet të përbëhen nga kontributet në Fondin e Pensionit të bëra nga ose në emër të punonjësve dhe fitimi që rrjedh nga investimi. Në rastin e Pensioneve me Kontribute të Caktuara, kontributet plus fitimet e investimit, minus shpenzimet, duhet të përbëjnë financimin e pensionit. Në Pensionet me Shuma të Caktuara, Fondi Pensional duhet të zhvillojë planin e financimit. Mjetet e pensioneve duhet të lejohen për t'u akumuluar në atë mënyrë që do t'i mundësojnë Fondit Pensional që në mënyrë adekuate të paguajë premtimet e pensioneve. Sponsorit është i detyruar që të sigurojë që premtimet ose detyrimet janë financuar në pajtim me nenin 14, paragrafi 11, të Ligjit për Fondet Pensionale.

- 1.3 *Promovimi dhe transparencë*. Fondet Pensionale duhet të promovojnë vetëm objektivat e Fondit të Pensionit, që të sigurojnë se pensionet dhe mjetet janë investuar vetëm për të mbështetur objektivat e pensionit. Menaxhimi i Fondit të Pensionit duhet të zhvillohet me transparencën më të lartë duke i kërkuar Bordit të Drejtorëve që të sigurojë informatat e caktuara për pjesëmarrësit në lidhje me mjetet dhe të drejtat e tyre përkatëse.
- 1.4 *Mbikëqyrja*. Investimi, mbajtja dhe shfrytëzimi i mjeteve të pensionit duhen të mbikëqyren për të siguruar se mjetet e pensioneve janë shfrytëzuar vetëm për pagesën e të drejtave të pensionit.
- 1.5 *Bllokimi (“locking”) i interesave të pjesëmarrësve*. Interesi i pjesëmarrësit në Fondin Pensional është e drejtë pronësore e tij/saj, mirëpo kjo e drejtë pronësore është në dispozicionin e tij/saj vetëm për pagesat e pensionit kur ta arrijë moshën e pensionimit apo pensionin invalidor, ose për përfituesin(it) e tij/saj në rast të vdekjes para fillimit të pensionit.

## **Neni 6**

### **Regjistri i Fondeve Pensionale**

BQK-ja mban dhe publikon Regjistrin e Fondeve Pensionale të licencuara.

## **Neni 7**

### **Zbatimi dhe masat përmirësuese**

Për shkeljet e dispozitave të kësaj rregulloreje, do të jenë subjekt i masave të parashikuara sipas legjislacionit në fuqi.

## **Neni 8**

### **Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje do të shfuqizohet Rregulla 12 për Themelimin e Fondit Pensional, e datës 25 korrik 2002.

## **Neni 9**

### **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas miratimit nga Bordi i Bankës Qendrore.

Flamur Mrasori

Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore